



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 446 Prot.

Tiranë, më 28.03 2019

VENDIM Nr. 72 datë 18.03.2019

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë" Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 3, datë 18.03.2019, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Topografia Epidamne-Dyrrhachion, Durrës" 2019*, drejtuar nga Prof.Asoc. Eduard Shehi, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Topografia Epidamne-Dyrrhachion, Durrës" 2019*, drejtuar nga Prof.Asoc. Eduard Shehi, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Gërmimi në oborrin e shkollës Jusuf Puka, i cili synon të identifikojë tiparet që kanë karakterizuar zgjerimin apo ngushtimin e qytetit antik drejt lindjes. Pas përfundimit të gërmimeve territori do të rikthehet në gjendjen e paragërmimit.
 - Gërmimi në mes të kullave D dhe E.
 - Gërmimi në një oborr të një banese, pronë e kishës katolike i cili synon të identifikojë evoluimin e qytetit antik nga origjina deri në antikitetin e vonë. Kjo sipërfaqe gjendet praktikisht në qendër të qytetit dhe na e ofron një mundësi të tillë. Gërmimi në këtë zonë është në varësi të marrëveshjes me pronarin e tokës. Pas përfundimit të gërmimeve territori do të rikthehet në gjendjen e paragërmimit.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2019.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al